



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS
SEKTORI I FINANCËS

Nr. 662 prot.

Klos, më 27.07 2024

Lënda: Analiza për Sektorin e Financës për vitin 2023.

Drejtuar : KËSHILLIT TË BASHKISË

Këtu

Mbështetur në ligjin 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore “, neni 54, shkronja dh, në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.në ligjin 10296, datë 08.07.2010, ndryshuar me ligjin nr.110/2015,datë 15.10.2015, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në ligjin nr.68/2017, për “Financat e Vetëqeverisjes Vendore” në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.07.2018, “ Për Procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive te Vetëqeverisjes Vendore”, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.20 datë 10.07.2019, “Për përgatitjen e Buxhetit” në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.79, datë 21.12.2022, për “Miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2023”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.82, datë 21.12.2022, për “Miratimin e Buxhetit të vitit 2023”, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2, datë 19.01.2023, “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023”, po paraqesim një analizë financiare për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Spektori i Financës gjatë vitit 2023 ka patur si objektiva kryesore:

1. Ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme te gjendjes financiare si: të ardhurat; shpenzimet, investimet dhe inventarizimin e pasurisë, në administratën e bashkisë dhe institucionet vartëse ;
2. Rritjen e efikasitetit dhe transparencës në të gjitha shpenzimet.

Bazuar në Ligjin 68/2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore”, neni 10, “Financimi i njësive të vetëqeverisjes vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifrat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

Edhe financimi i buxhetit të Bashkisë Klos realizohet nga:

- Nga burimet e veta vendore ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen.
- Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë, transfertat sektoriale dhe transfertat e kushtëzuar.
- Nga grantet e projekteve të huaja dhe donacionet, ku përfshihen grantet e përfituara përmes thirrjeve për propozime, për zbatimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar etj. në përputhje me ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve të financimit dhe VKM-ve për miratim në parim të marrëveshjeve të financimit.

Fondet (të ardhurat) për në Buxhetin e vitit 2023 detajohen si më poshtë:

1. Transferta e pakushtëzuar	204,850,655 lekë
2. Transferta sektoriale	76,049,157 lekë
3. Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023	60,000,000 lekë
4. Transferta të kushtëzuara	445,979,326 lekë
5. Fonde të trashëguara nga viti 2022	41,110,461 lekë
6. Fonde nga Bashkimi Evropian (Muzeu)	9,829,625 lekë
7. Fonde nga Bashkimi Evropian (Hapat e parë)	5,080,570 lekë
8. Transfertë nga Këshilli i Qarkut	1,500,000 lekë
Shuma gjithsej	844,399,794 lekë

Duke parë burimin e të ardhurave të Bashkisë Klos vëmë re që të ardhurat nga burimet qendrore rezultojnë të jenë element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia financiare nga transfertat ndërqeveritare ka bërë që planifikimi i investimeve kapitale të jetë subjekt i kushtëzuar pothuajse tërësisht nga vendimet e qeverisë qendrore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga qeverisja qendrore transfertat të pakushtëzuara të cilat përdoren në autonomi të plotë dhe transfertat të kushtëzuara të cilat përdoren në mënyrë të përcaktuar nga organi që jep transfertën.

Në bazë të shkresës në lidhje me njoftimin e transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale, për vitin 2023 Bashkia Klos ka përfituar transfertë të pakushtëzuar në shumën 166,387,795 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, pra 21,657,567 lekë më shumë se në vitin 2022.

Përveç kësaj Bashkisë i janë transferuar 7,912,632 lekë për rritjen e pagave si dhe 30,792,224 lekë për t'u përdorur për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Transferta sektoriale për vitin 2023 është në shumën 73,071,843 lekë, pra 2,914,010 lekë më shumë se në vitin 2022.

Përveç kësaj Bashkisë i janë transferuar 2,735,318 lekë për rritjen e pagave.

Transferta sektoriale është shpërndarë si më poshtë:

Arsimi parashkollor

Në transfertën sektoriale të vitit 2023 me një vlerë totale 34,177,876 lekë, janë fondet për pagat e personelit edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, në vlerën 1,479,600 lekë më shumë se në vitin 2022.

Arsimi parauniversitar

Në transfertën sektoriale të vitit 2023 me një vlerë totale 1,953,911 lekë, janë fondet për pagat e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar, me një shumë prej 77,040 lekë më shumë se në vitin 2022.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Në transfertën sektoriale të vitit 2023, janë fondet për pagat e punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, për shpenzime operative dhe për investime me një vlerë totale 14,570,433 lekë, me një shumë prej 704,602 lekë më shumë se në vitin 2022.

Rrugët rurale

Në transfertën sektoriale të vitit 2023, janë fondet për rrugët rurale të transferuara, në një vlerë totale 11,170,822 lekë, me një shumë prej 303,847 lekë më shumë se transfertat sektoriale të vitit 2022. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime.

Administrimi i pyjeve

Në transfertën sektoriale të vitit 2023, janë fondet për shërbimin pyjor me një vlerë totale 8,135,665 lekë, me një shumë 270,000 lekë më shumë se në vitin 2022.

Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve.

Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën sektoriale të vitit 2023, janë fondet për ujitjen dhe kullimin me një vlerë totale prej 3,063,136 lekë, në shumën 78,921 lekë më shumë se në vitin 2022.

Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve për blerje materiale për kanalet vaditëse.

Në transfertën e kushtëzuar përfshihen:

Pagat dhe sigurimet për punonjësit e gjendjes civile në shumën 4,215,900 lekë.

Fondi për njoftimin e zgjedhësve në shumën 62,644 lekë, transporti për materialet zgjedhore në shumën 149,500 lekë, si dhe fondi për mbështetjen e fëmijëve në nevojë në shumën 131,760 lekë.

Fondi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Ndihmën Ekonomike dhe Paaftësinë në shumën 290,824,000 lekë, si dhe 21,641,000 lekë për pagesën e vendimeve gjyqësore të PAK.

Fondi nga AKUM për investimin “Sistemim i KUZ dhe KUB në rrugët e Riza Beg Çela dhe Murat Basha, Bashkia Klos”, dhe mbikqyrjen në shumën 15,150,000 lekë.

Fonde nga Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile 2,958,410 lekë për përdorim në raste

emergjencash , 48,873.112 lekë për Ndërtimin e Urës së Domit, si dhe 875,000 lekë për shpërblimin e zjarrëfikësve.

Fondi nga Ministria e Arsimit në shumën 36,125,000 lekë për Rikonstruksionin e shkollës Mesme "Haxhi Lata" Suç dhe ndërtim palestre.

Fond për shpërblim komisione zgjedhore KZAZ,KVZ,GNV në shumën 1,390,000 lekë.

Shpërblim për ish-Kryetarin 200,000 lekë.

Fonde për strehimin social 17,952,000 lekë.

Fonde nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për likujdim detyrimi "Rikonstruksion I kanalit vaditës Cerujë", në shumën 2,224,000 lekë.

Fonde nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin "Me komunitetin. për komunitetin", në shumën 1,938,000 lekë.

Fonde nga Ministria e Brendshme për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për bonusin e e bebes në shumën 1,350,000 lekë.

Në planifikimin e të ardhurave të vitit 2023 përfshihen të ardhurat e parashikuara në fillim të vitit për tu mbledhur në shumën 60,000,000 lekë, me një shumë prej 10,000,000 lekë më pak se të ardhurat e parashikuara për vitin 2022.

Fondet e trashëguara nga viti 2022 janë 6,584,707 lekë nga të ardhurat dhe 34,525,754 lekë nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta sektoriale.

Ndërsa në kuadër të Programit IPA II -bashkëpunimi ndërkufitar, për vijueshmërinë e projektit "Ndërtim muzeu historik në Bashkinë Klos dhe zbulimi i shtigjeve të fshehta", me

bashkëfinancim me Bashkimin Evropian të ardhurat nga BE janë në shumën 9,829,625 lekë. Projekti është nënshkruar në nëntor 2019. Implementimi i projektit ka vazhduar më 01.12.2019 dhe ka vazhduar të implementohet për 20 muaj nga data e fillimit të implementimit.

Fonde nga Bashkimin Evropian për projektin "Hapat e parë" në shumën 5,080,570 lekë.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.35, datë 21.09.2020, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", është hapur numër llogarie në Credins Bank, dega Burrel, për kryerjen e veprimeve financiare.

Është lidhur kontrata me datë 05.07.2023, me objekt "Park inovativ rekreacioni", me sipërmarrës "RADIKA" shpk.

Llogaria në Credins Bank ka funksionuar pas transferimit të parave të financimit të huaj.

Për vitin 2023 janë planifikuar 5,080,570 lekë të ndara si më poshtë vijon:

- Paga-404,894 lekë (Janë likujduar 404,894 lekë)
- Sigurime shoqërore dhe shëndetësore -67,620 lekë (Janë likujduar 67,620 lekë)
- Shpenzime operative-1,204,559 lekë (Janë likujduar 906,215 lekë)

- Investimi -3.403,497 lekë (Janë likujduar 2,620.000 lekë)

Pra likujdimi i këtyre fondeve është realizuar në bankë dhe në evidencën e Thesarit nuk është i pasqyruar realizimi në vlerën 3,998,728.65 lekë.

Kjo pasqyrohet në statement e bankës të nr.të llogarisë së bashkisë të çelë për projektin.

Analiza e të ardhurave

Plani i të ardhurave për vitin 2023 bashkë me ndryshimet është 77,914,332 lekë. Përveç të ardhurave të planifikuara në fillim të vitit 2023 në shumën 60,000,000 lekë përfshihen edhe të ardhurat e trashëguara të papërdorura nga viti 2022 në vlerën 6,584,707 lekë, shtesa nga fondet e Bashkimit Evropian në shumën 9,829,625 lekë dhe 1,500,000 lekë janë transfertë nga Këshilli i Qarkut Dibër për “Mobilimin e Muzeut” dhe “Shpenzime për Festivalin e Gjirokastrës” dhe shpenzime për festat e nëntorit.

Të ardhurat e mbledhura për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 janë 40,466,683.6 lekë, por 1,500,000 lekë janë transfertë nga Këshilli i Qarkut Dibër, 3,723,000 lekë janë fonde nga BE.Pra në total të ardhurat janë 35,243,683.6 lekë dhe paraqiten si më poshtë vijon:

ART	LLOJI I TE ARDHURAVE	Totali I arketuar
7002100	Taks vendore biznesi	
7002200	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	81,369
7020100	Tatim token	558,625
7020200	Tatim ndertese	2,040,705
7029200	Taksa per kalim pronesie	36,391
7035003	Leje ndertimi	3,889,580
7035008	Takse reklame	227,950
7035009	Takse tabele	16,802
7035011	Tarufe shfrytezimi lende drusore	2,005,200
7035014	T.vend. pastrimi	2,859,852
7035015	T. perkohshme per infrastrukture arsimore	771,400
7035023	Tarif vendore ndriçimi	344,370
7035024	Tarif vendore per dhenie leje mjedisore	1,006,850
7035025	Takse Vendore per truallin	533,269
7035026	Takse Vendore per ujin	479,800
7035028	Tarif vendore per çert. E perdorimit	21,000
7035032	Tarif vend. Per shqyrtim leje zhvillim	
7035033	Tarife per leshime vertetimi	112,370
7035040	Tarif vend. Per leje ndertimi	38,000

7035050	Tarife vendore nga hidrocentrali ujqor	
7035099	Te tjera taksa e tarifa	
7109200	Qera per troje	1,788,775
7109400	Te ardh. Nga shfrytz. I nentokes	3,838,100
7109600	Qera ndertese	58,200
7109700	Te ardhura nga qira per paisjet	
7109900	Te Tjera TA nga ndërmarrjet dhe pronësia	
7110106	Leje trasporti	620,492
7110501	Tarifa pastrimi	
7110504	Tarif per rregj. Per vendb. Te ri	
7111007	Te aedhuea nga parkingu	100,000
7110599	Te tjera tarifa administer.	
7113099	Te tjera tarifa Sherb.(uji I pishem).	
7111001	Te ardh. Kopshtet	922,460
7113001	Te ardh. nga shit e prod.bujq.dhe pyjore	
7111099	Te tjera	
7115499	Te tjera gjioba	3,000
7115500	Kamat vonesa	215,788
7115600	Sekuestrime dhe zhdemtime	302,736
7190990	Te ardhura te tjera jo tatimore	
7200102	Grant nga Qarku	1,500,000
7204101	T.e Automjeteve (grant)	6,178,368
7204100	Renta minerare	90,614
7204102	Te Ardhura TAP	6,101,618
7207010	Spons. Nga organizata joqeveritare	0
7210100	Grante nga qeveri te huaja	3,723,000
	SHUMA	40,466,684

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar 1,326,855.4 lekë më pak.

Analiza e shpenzimeve vendore

Shpenzimet vendore

Në këtë seksion paraqitet një analizë e shpenzimeve të Bashkisë bazuar në natyrën ekonomike të shpenzimeve (p.sh.pagat e personelit, shpenzimet operative dhe investimet) dhe sipas klasifikimit të funksioneve të qeverisjes vendore (administratë, sektori i ujësjellësit, sektori i bujqësisë,) dhe

funkcionet specifike si: ujitja dhe kullimi, sektori i rrugëve, sektori i pyjeve, arsimit, zjarrfikset, etj.).

Në total, shpenzimet e kryera nga njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Klos gjatë vitit 2023, regjistruan një vlerë prej rreth 657,324,167.65 lekë nga 844,399,794 lekë që ishin planifikuar.

Si rezultat përqindja e realizimit total të shpenzimeve në vitin 2023 regjistron 77.87 %.

Pagat dhe Sigurimet

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime) për 12 mujorin 2023 arritën vlerën 164,765,482 lekë në raport me planin vjetor 179,283,107 lekë dhe si rezultat përqindja e realizimit total të shpenzimeve për paga dhe sigurime për vitin 2023 regjistron 91.9 %.

Ndërsa për vitin 2022 shpenzimet për paga dhe sigurimet janë në vlerën 155,214,432 lekë në raport me planin vjetor 167,217,924 lekë.

Ndarja në paga dhe sigurime me transfertë dhe paga dhe sigurime me të ardhura për vitin 2023 :

- Plani vjetor me transfertë të pakushtëzuar dhe sektoriale për paga dhe sigurime është 160,752,607 lekë
Fakti vjetor është 155,364,305 lekë.
Realizimi është në masën 96.65 %.
- Plani vjetor me transfertë të kushtëzuar për paga dhe sigurime është 6,399,900 lekë.
Fakti vjetor është 5,949,850 lekë.
Realizimi është në masën 92.97 %.
- Plani vjetor me të ardhura për paga dhe sigurime është 11,658,086 lekë
Fakti vjetor është 2,978,813 lekë.
Realizimi është në masën 25.55 %.
- Plani vjetor me fondet e BE për paga dhe sigurime është 472,514 lekë
Fakti vjetor është 472,514 lekë.
Realizimi është në masën 100 %.

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative të realizuara gjatë vitit 2023 arritën vlerën 50,451,593 lekë 76,619,685 në krahasim me shumën lekë të planifikuar.

Duke ju referuar planit të shpenzimeve realizimi është në masën 65.85 %.

Ndërsa për 6 mujorin e vitit 2022 shpenzimet operative të realizuara arritën vlerën 62,128,210 lekë në krahasim me shumën 81,076,880 lekë të planifikuar.

Ndarja në shpenzime operative me transfertë dhe shpenzime operative me të ardhura për vitin 2023 :

- Plani vjetor me transfertë për shpenzime operative është 64,952,157 lekë
Fakti vjetor është 43,209,685 lekë.
Realizimi është në masën 66.52 %.

- Plani vjetor me të ardhura për Shpenzime Operative është 10,462,969 lekë
Fakti vjetor është 6,335,693 lekë.
Realizimi është në masën 60.55 %.
- Plani vjetor me fondet e BE për Shpenzime Operative është 1,204,559 lekë
Fakti vjetor është 906,215 lekë.
Realizimi është në masën 75.23 %.

Shpenzimet për transferta për buxhetet familjare dhe individët në nevojë (funksion i deleguar) gjithashtu janë një zë i rëndësishëm në totalin e shpenzimeve vendore. Gjatë vitit 2023 transfertat e kushtëzuara për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë janë çelur në shumën 290,824,000 lekë dhe janë likujduar 276,416,116 lekë .

Fondi për njoftimin e zgjedhësve në shumën 62,644 lekë, është likujduar në shumën 47,791 lekë. Fondi i transportit të materialeve zgjedhore i çelur në shumën 149,500 lekë është likujduar në shumën 129,100 lekë.

Fondi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i çelur në shumën 21,641,000 lekë për pagesën e vendimeve gjyqësore të PAK është likujduar në masën 21,639,008 lekë.

Fond për shpërblim komisione zgjedhore KZAZ, KVZ, GNV në shumën 1,390,000 lekë.

Shpërblim për ish-Kryetarin 200,000 lekë janë likujduar sipas çeljeve nga Ministria.

Fonde për strehimin social 17,952,000 lekë janë likujduar në masën 17,595,000 lekë.

Fonde nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin, “Me komunitetin, për komunitetin”, në shumën 1,938,000 lekë janë likujduar në vlerën 390,503 lekë.

Fonde nga Ministria e Brendshme për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për bonusin e e bebes në shumën 1,350,000 lekë janë likujduar të gjitha.

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale janë një zë tjetër shumë i rëndësishëm për buxhetin e vitit 2023.

Theksojmë se këto shpenzime për vitin 2023 janë realizuar në vlerën 126,905,127 lekë kundrejt planit 251,289,688 lekë.

Realizimi është në masën 49.46 %.

- Plani vjetor me transfertë për investime është 89,720,802 lekë
Fakti vjetor është 67,462,802 lekë
- Plani vjetor me të ardhura për investime është 55,793,277 lekë
Fakti vjetor është 10,892,471 lekë.
Plani vjetor me fonde të kushtëzuara për investime është 102,372,112 lekë
Fakti vjetor është 45,929,854 lekë.
- Plani vjetor me fondet e BE për investime është 3,403,497 lekë
Fakti vjetor është 2,620,000 lekë.

Ndërsa për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 99,631,767 lekë kundrejt planit 160,150,911 lekë.

Analiza e kontratave me vlerë mbi 1,200,000 lekë.

Janë nënshkruar nga ana e Bashkisë Klos në cilësinë e autoritetit kontraktor këto kontrata për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 me të dhënat përkatëse si më poshtë:

1. Objekti: Blerje naftë

Data e lidhjes së minikontratës 05.01.2023, bazuar në kontratën e datës 15.03.2022.

Subjekti me të cilin është nënshkruar marrëveshja kuadër Mend OIL” Sh.p.k përfaqësuar nga Z.Ermalt Gërbolli

-Vlera e minikontratës 1: 6.530,400 lekë me Tvsh, me afat 6 mujor.

Financimi: Me transfertë të pakushtëzuar dhe me transfertë specifike.

Është likujduar vlera 6,529,824 lekë.

-Vlera e minikontratës 2 : 4,469,600 lekë me Tvsh, me afat 6 mujor.

Financimi: Me transfertë të pakushtëzuar, me transfertë specifike dhe të ardhura.

Është likujduar vlera 4,469,023 lekë.

2. Objekti: Blerje materiale kanalesh vaditëse, riparim rrugësh, ujësjellësi, elektrike dhe mirëmbajtje shkollash

Data e lidhjes së minikontratës 06.01.2023, bazuar në kontratën e datës 10.05.2022.

Subjekti me të cilin është nënshkruar marrëveshja kuadër :”Ilir Dedolli”. P.F

Vlera e kontratës: 7,082,753 lekë me Tvsh, me afat 1-vjekar.

Financimi: Me transfertë të pakushtëzuar, me transfertë specifike dhe një pjesë me të ardhura.

Është likujduar shuma 7,079,856 lekë.

3. Objekti: Park inovativ rekreacioni

Data e lidhjes së kontratës 05.07.2023.

Subjekti me të cilin është nënshkruar kontrata :”RADIKA”. Shpk, përfaqësuar nga Besmir Muça.

Vlera e kontratës: 3,502,944 lekë me Tvsh.

Financimi: Me financim nga Bashkimi Europian (vlera pa TVSH) dhe TVSH nga transfertat e pakushtëzuar.

Është likujduar shuma 2,620,000 lekë.

4. Objekti: Rikonstruksion + Ndërtim palestre Shkolla e Mesme e Bashkuar Haxhi Lata, Suç.

Data e lidhjes së kontratës 27.09.2023, me afat 6 muaj

Subjekti me të cilin është nënshkruar kontrata :”SIRETA 2F”. Shpk, përfaqësuar nga Fatime Pali.

Vlera e kontratës: 82,460,160 lekë me Tvsh, nga të cilat 39,362,371 lekë financim i vitit 2023 dhe 43,097,798 lekë financim i vitit 2024.

Financimi: Me fonde të kushtëzuara në vlerën 72,250,000 lekë dhe me transfertë të pakushtëzuar 10,210,169 lekë.

Është likujduar shuma 16,125,000 lekë.

Data e lidhjes së kontratës 28.09.2023, me afat 6 muaj.

Subjekti me të cilin është nënshkruar kontrata BOE : “Vëllezërit HYSA” dhe “RADIKA”shpk.

Vlera e kontratës: 84.604,287 lekë me Tvsh, nga të cilat 48.873,112 lekë financim i vitit 2023 dhe 35,731,175 lekë financim i vitit 2024.

Financimi:Me fonde të kushtëzuara.

Është likujduar shuma 10,049,340 lekë.

Detyrimet e prapambetura.

Nga rakordimet e Bashkisë me degën e thesarit Mat në lidhje me tabelën e borxhit të papaguar sipas instrumentit dhe detyrimet e prapambetura ndaj palëve të treta deri me 31.12.2023 të regjistruara ne Sistemin informatik të Qeverisë(SIFQ) qëndrojnë në nivelin 88,691,913 lekë. nga të cilat 11,146,662 janë detyrime të FSHZH, 9,829,625 lekë janë detyrime nga Bashkimi European dhe dhe 67,715,626 lekë janë detyrime të Bashkisë.

Nga detyrimet që ka Bashkia, detyrime me financim të ardhurat e institucionit janë në shumën 24,133,339 lekë, ndërsa detyrime me financim nga transferta e pakushtëzuar janë 43,582,827 lekë.

Krahasuar me datën 31.12.2022 ku detyrimet e regjistruara ne Sistemin informatik të Qeverisë(SIFQ) qëndrojnë në nivelin 35,016,518 lekë, nga të cilat 11,146,662 lekë janë detyrime të FSHZH dhe 23,869,856 lekë janë detyrime të Bashkisë.

Detyrimet e prapambetura janë rritur me 43,845,770 lekë.

Kjo për arsye të faturës nr.95/2022, datë 31.12.2022 për objektin “Sistemim asfaltim rruga Pleshe-Cerujë dhe Cerujë- Patin”, likujdimi i së cilës ishte parashikuar në tre vite; nga 2022-2024, ku për vitin 2022 është likujduar shuma 23,903,648 lekë, për vitin 2023 është likujduar 67,042,327 lekë. ndërsa për vitin 2024 parashikohet likujdimi i shumës 59,133,339 lekë.

Bazuar në udhëzimin nr.5 datë 27.02.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” të ndryshuar, pika 20 procesi i ekzekutimit të pagesave për detyrimet e prapambetura, është bërë dhe do të bëhet duke respektuar radhën kohore të lindjes së detyrimit sipas listës që disponon sektori i financës.

Proçedurat e ndjekura nga bashkia për shlyerjen e detyrimeve do te jenë transparente, të besueshme dhe të drejta.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË FINANCËS

Silvana BALA

KRYETARI

Valbona KOLA



Adresa: Rruga “Jaho Hoxha”, Ndërtesa nr.2, Hyrja nr.2, Klos-Shqipëri, e-mail:info@bashkia.klos.gov.al